



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.519/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, Fakete Dushi, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, paraqitur për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 25.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e palejuar ankesa e parashtruar nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, Fakete Dushi, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri me shenjën ZL.A.nr.519/2017 e datë 25.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

A r s y e t i m

Me datën 25.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga kandidatja për anëtare të Kuvendit Komunal Fakete Dushi, nga radhët e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, dega në Vushtri, me të cilën ka pretenduar se me datë 22.10.2017, në fshatin Nedakovc në Qendrën e Votimit 2708B/01R dyshon se i mungon vota si dhe në Qendrat e Votimit 2714B-Maxhunaj, 2702B- Ali Kelmend, 2702X në të gjitha klasët, 2721B në të gjitha klasët, 2709B Novolan, 2707B Dumnicë, 2729B Stanovc i Poshtëm.

Paneli, pasi që shqyrtoj paraprakisht lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli, nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljen e pretenduar, në ankesë sepse, pretendimet ankimore që ndërlidhen me rezultatin e votimit duhet të parashtrohen pas shpalljes së rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procedurës.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankuesit. Hudhja e ankesës së kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal në Vushtri Fakete Dushi, nuk e

paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesë, pas shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL. Anr.519/2017 më datën 25.10.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.